



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 198 Regj. Themeltar



VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

**Kryesuese:** Alkelina Gazidedja  
**Anëtar :** Enkelejda Metaliaj (Softa)  
**Anëtar :** Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Sonja Traja**, sot më dt. **10.08.2020** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me palë:

**PADITËS:** **Ardita Buna**, e datëlindjes 10.07.1971, lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë , në adresën “Rruga e Barikadave”, Nr.2, Tiranë.

**I PADITUR:** **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, me adresë Rr “Ibrahim Rugova” ndërtesa nr.20, 1001 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Besmir Rrapaj, këshilltar i Gjykatës së Lartë dhe pranë KED-së me autorizimin e lëshuar nga ZV/Kryetari i KED-së me nr.179 Prot, datë 30.07.2020.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për “Ndalimin e kandidimit të kandidatës, Ardit Buna, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakantë e përkohshme e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 149/b, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”. Neni 238 i ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Neni 44 dhe 50/c e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Vendimi nr. 4, dtë 11.03.2019 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.



Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoji dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

**Paditësja Ardita Buna kërkoji:** Pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 17.07.2020 të palës së paditur KED.

**Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoji:** Rrëzimin e padisë.

### VËREN

Është pranuar dhe rezulton në gjykim se paditësja Ardita Buna ka shprehur interesin për vendin vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 28.08.2018 dhe të rishpallur me datë 21.08.2019.

Për kërkesën e paraqitur nga paditësja është hedhur shorti për caktimin e relatorit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 5, 27 - 37 dhe 41 të Vendimit nr. 2 datë 15.02.2019, dhe për paditësen është përcaktuar relatore znj. Vitore Tusha.

Në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” paditësja është njoftuar me shkrin, nëpërmjet rrugës elektronike për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës.

Në datën 23.09.2019, kandidatja Ardita Buna (Alsula) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj.

Në datën 24.09.2019, kandidatja Ardita Buna (Alsula) ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj për pozicionin e shpallur vakant.

Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” me shkresën nr. 548 prot, datë 04.10.2019, KED i ka dërguar ILDKPKI-se listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me to që i nënshtrohen



procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr.8577/2000 dhe ligjit nr.115/2016.

Me shkresën nr.107/27, datë 06.11.2019 ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Ardita Buna e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 për të dorezuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Pozicione të ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën, nr.4186/6 prot, datë 06.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Ardita Buna dhe personat e lidhur me të.

I padituri, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, ka kryer veprimet verifikuese të kerkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Ardita Buna dhe personave të lidhur me të.

Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, i padituri Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka njoftuar kandidaten Ardita Buna në datën 11.08.2019, në rrugë elektronike, për të marrë të dhënat mbi raportin e hartuar nga ILDKPKI si dhe të mundësojë dhënien e shpjegimeve përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

Paditësja, kandidatja Ardita Buna, në datë 14.11.2019, në rrugë zyrtare, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, i cili është protokolluar pranë sekretarisë së KED-së.

Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtari i Këshillit relatori çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Zv/Kryetari i KED-së ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, rendin e ditës, si edhe duke i

bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin, e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidaturës së znj. Ardita Buna për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë.



Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Ardiana Buna.

I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

Pas përfundimit të procedurës dhe shqyrtimit të kandidaturës së paditëses në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë, pala e paditur KED me vendimin nr.11, datë 17.07.2020, ka vendosur: *“Ndalimin e kandidimit të kandidates Ardita Buna (Alsula), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019”*.

Pala e paditur KED, në vendim, ka arsyetuar:

*Në përballje të fakteve dhe konkluzioneve të gjetura dhe të arritura nga ILDKPKI-ja, sipas të cilave për znj. Ardita Buna (Alsula) “Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin” dhe “Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasurinë”, me të drejtën e parashikuar nga neni 235 i Ligjit nr. 115/2016, evidentohet se Znj. Ardita Buna (Alsula), nuk ka sukses në kalimin e procesit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së saj personale dhe të familjarëve të saj. Kështu, nga deklarimet e kryera dhe nga dokumentacioni i administruar nga Këshilli, sikurse ka konkluduar edhe ILDKPKI-ja, konstatohet se ka mospërputhje të çmimit të blerjes së apartamentit në vitin 2002 në raport me vlerën e individualizuar në kontratën e shitjes. Gjithashtu, pasaktësi është vërejtur edhe në mënyrën e realizimit të kontratës së porosisë në raport me madhësinë e sendit (garazh) objekt të kontratës së porosisë, si dhe mospërputhje midis shkakut të marrjes së kredisë (rikonstruksion banese), me përdorimin e shumës së disbursuar (për blerjen e garazhit). Dokumentacioni i paraqitur pranë ILDKPKI-së dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi prej kandidates, për të justifikuar deklarimet apo pretendimet e saj, nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën e konkluzioneve të paraqitura si më lart. Në këto rrethana, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludon se kandidatja Ardita Buna (Alsula) nuk plotëson kushtet e parashikuara nga*



*Ligji nr. 8577/2000 i ndryshuar, konkretisht në shkronjën "dh" të pikës 1 të nenit 7/a, të ligjit të cituar."*

Pala e paditur KED në zbatim të ligjit ka njoftuar palën paditëse për vendimin e marrë prej saj. Paditësja pasi është njohur me vendimet e marra nga i padituri KED dhe duke mos qenë dakort me të, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit në datë 03.08.2020.

### Pretendimet e palëve

#### **Pala paditëse kërkoi pranimin e padisë shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 17.07.2020 të palës së paditur KED, duke pretenduar se:**

- Pala e paditur pretendon se nga ana e KED-së është shkelur pika 34, germa B, Kreu i III "Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i cili parashikon se *"Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së bashku me relacioni e përgatitur nga relatori i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit ..."*
- Rezulton që seanca e datës 17.7.2020 nga ana e KED është zhvilluar në shkelje të rënda proceduriale në shkelje të nenit 229/2, të ligjit nr.115/2016, dhe të vendimit nr. 4, datë 11.3.2019 të KED
- Në datën 13.7.2020 paditësja është njoftuar me një e-mail nga KED, ku relacioni i dërguar në përmbajtje është i ndryshëm me vendimin e marrë nga KED. Në përmbajtje të vendimit në pikën 30 (fage 7) thuhet *"... Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 76 dhe 77 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019, duke vlerësuar se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit. anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit ..."*. Pra ndryshe nga sa është arsyetuar relacioni që është dërguar përmban vetëm të dhëna të tjera. Siç vihet re nga vetë përmbajtja e vendimit tek pjesa arsyetuese, rezulton se relatorja e çështjes ka paragjykuar si dhe ka paracaktuar mos lejimin e kandidimit.
- KED ka zhvilluar një mbledhje formale duke shkelur me këmbë procedurën. Është i pavërtetë fakti i parashtruar në vendim se paditësja është njoftuar në datën 14.7.2020. Në reference të arsyetimit të vendimit rezulton se Avokati i Popullit me të drejtë ka konstatuar faktin se nuk jam njoftuar lidhur me gjetjet si dhe me kohën e kryerjes së veprimeve. Gjatë zhvillimit KED ka shkelur nenin 47, të ligjit nr.44/2015 *"Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës kanë të drejtë të paraqesin mendime, dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështje"*.
- KED ka shkelur parimin e paanësisë në mënyrë të drejtëpërdrejtë, dhe kjo del qartësisht nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit, *"duke vlerësuar se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës"*.



- KED ka shkelur haptazi parimin e objektivitetit, pasi relatori i çështjes ka përgatitur një relacion, në mungesë të shqyrtimit të provave të depozituara nga ana ime si dhe duke mos argumentuar prapësimet e mia në lidhje me gjetjet e pasqyruara nga raporti i ILDKPI. Për sa kohë që mbledhjet e KED, ndryshe nga standarti tashmë i konsoliduar i organeve të drejtësisë KLP, KPK, KPA, etj, zhvillon seancat për shqyrtimin e kandidaturave pa praninë e palëve.

- Rezulton se ky i fundit punon me dy standarte dhe mohon të drejtën për tu dëgjuar dhe për të depozituar provat. Vendimi i KED, për ndalimin e kandidimit për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese arsyetuar dhe në mungesë të pasqyrimin të rrethanave, fakteve dhe provave, kjo në kundërshtim me nenin 100 të ligjit nr. 44/2012, dhe nenit 235, pika 4 e ligjit nr. 115/2016. Në pjesën arsyetuese të vendimit konstatohet mospasqyrimi i provave të marra në shqyrtim, analiza e provës në veçanti dhe në tërësi, si dhe mungon vlerësimi i tyre dhe lidhja e provave me konkluzionin.

- Vendimi i KED është kontradiktor pasi nuk përputhet pjesa arsyetuese e vendimit me dispozitivin. Citohen pikat 40, 52, 53, 54, 55 dhe 57 të vendimit objekt ankimi. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të argumentonte një për një të gjitha kundërshtimet e mia dhe provat dhe arsyen pse ato nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën e konkluzioneve. Arsyetimi i vendimit në rastin konkret mbart një detyrim ligjor të shtuar për shkak të zbatimit të parimit të diskrecionit dhe të parimit të proporcionalitetit.

- Mungesa e arsyetimit të vendimit të KED e bën këtë vendim të pavlefshëm. KED ndryshe nga vendimet e mëparshme lidhur me nevojën për marrjen e një eksperti, kësaj rradhe i ka rënë shkurt duke gjykuar me dy standarte. Megjithatë thirrja e ekspertit është bërë nga KED në vitin 2019, me përbërje të ndryshme, procedura dhe njoftimi ka filluar që në vitin 2019, që përbën shkelje të hapur dhe gjykimi me dy standarte. Ky fakt është konkluduar dhe nga Gjykata Administrative e Apelit në vendimin 201, datë 22.8.2019.

### **Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkoi rrëzimin e padisë duke prapësuar se:**

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pretendimi i palës paditëse për shkeljen e procedurës për shkak të paragjykimit të çështjes nga ana e anëtares relatores të çështjes është i pabazuar në ligj dhe se si i tillë duhet të rrëzohet. Neni 30 dhe 31 i Kodit të Procedurave Administrative parashikojnë ndër të tjera shkaqet dhe procedurën e konstatimit të papajtueshmërisë së një anëtari të një organi kolegjal. Ndër të tjera neni 30 parashikohen rastet kur anëtari i organit kolegjal nuk duhet të përfshihet në një procedurë vendimmarrëse.

Sikurse mund të konkludohet nga leximi i rasteve të sanksionuara në mënyrë indikative në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative, sjellim në vëmendje se pala paditëse në këto raste nuk evokon asnjë nga rastet e parashikuara në këtë nen. Megjithatë potencialisht rrethana e kontestuar e palës paditëse në padi është fakti që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në një rresht të një vendimi ndalimi kandidimi prej 13 faqesh ka formuluar, në një pjesë të nënrenditur në fjalisë se “*duke vlerësuar se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit*”, mund të përfshihet ligjërisht në shkronjë “h” të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Për të qenë kështu do të duhet që



të gjendet një dispozitë e legjislacionit në fuqi që e parashikon mënyrën e arsyetimit apo hartimin e relacionit të anëtarit të organit kolegjal si shkak përjashtimi i tij.

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se një pretendim i tillë është haptazi i pabazuar, pasi mënyra e arsyetimit të vendimit të organit kolegjal nga anëtari relator dhe investimi i tij kolegjal më vonë nuk mund të jetë kurrsesi shkak për anësinë dhe përshtatshmërinë e pjesëmarrjes në shqyrtim të anëtarit relator. Aq më pak kjo rrethanë nuk mund të jetë kurrsesi shkak papajtueshmërie për vetë trupën kolegiale dhe se nuk mund të prekë apo cenojë parimin e paanësisë së organit kolegjal. Duhet të kuptohet se puna përgatitore e anëtarit relator të trupës kolegiale është e tillë që njeh në dinamikë të gjithë rezultatet e hetimit administrativ dhe se natyrshëm gjatë dinamikës së realizimit të kësaj pune krijohet edhe opinionimi ligjor mbi gjithë informacionin që ka dosja dhe më tej edhe mbi mundësitë e ndryshme të zgjidhjes së çështjes. Një punë dhe metodikë e tillë shqyrtimi dhe administrimi e dosjes nga organi kolegjal realizohet universalisht nga organet administrative, gjykatat e apelit apo Gjykata e Lartë, përfshirë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, apo edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

- Relatori apo relatorët e çështjes gjithmonë e kanë detyrë ligjore të realizojnë studimin e rrethanave, ligjit, praktikës gjyqësore, jurisprudencës dhe më tej edhe të formësimit të konkluzioneve të rrjedhura logjikshëm nga analiza, konkluzione të cilat janë baza embrionale e projektvendimit të ardhshëm jopërfundimtar apo përfundimtar të trupës kolegiale. Ky është një detyrim ligjor i anëtarit relator dhe se nuk mundet apriori të konkludohet se realizimi i detyrës ligjore nga anëtari i një trupe kolegiale do të shërbejë si shkak për përjashtimin e tij dhe më tej për cenimin e parimit të paanësisë. Gjatë gjithë periudhës shumë mujore të procesit të verifikimit të kandidimit nuk ka rezultuar asnjë kërkesë e palës paditëse për përjashtimin e anëtares relatores dhe se as anëtarja relatores e çështjes nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi. Për rrjedhojë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk gjen asnjë rrethanë apo fakt relevant dhe real për të mbështetur pretendimet e palës paditëse.

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pretendimi i palës paditëse për mos njoftimin me aktet e çështjes së saj është haptazi i pabazuar në provat e fashikullit dhe se e kundërta del edhe nga pohimet e saj në sqarimet e parashtruara në padi dhe se për rrjedhojë këto pretendime duhet të rrëzohen. Vetë kandidatja paditëse sjell në vëmendje dhe pranon në faqen 4 të padisë se relacioni i anëtares relatores i është dërguar dhe njoftuar me email asaj me datë 13.04.2020, pra 4 ditë para mbledhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ju bëjmë me dije se po në këtë datë dhe se po me email është njoftuar pikërisht ky relacion edhe tek Zëvendëskryetarja dhe anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe se e njëjta gjë ka ndodhur edhe me Avokatin e Popullit. Gjithashtu në faqen 7 të tekstit të padisë paditësja pranon se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka njoftuar në rrugë elektronike për rezultatet dhe konkluzionet e hetimit nga ILDKPKI, duke e ftuar për të dhënë sqarimet dhe për të paraqitur dokumente justifikues. Kandidatja pranon në faqen 7 të padisë se ajo ka parashtruar me shkrim sqarime mbi konkluzionet e ILDKPKI me datë 14.11.2019 dhe se këto konkluzione janë administruar nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Ju sjellim në vëmendje se këto konkluzione jo vetëm janë administruar, por edhe janë sjellë në vëmendje në mënyrë të përmbledhur në vendimin objekt padie dhe se mbi to është arsyetuar dhe nxjerrë konkluzioni që përbën *thema decidendum* të vendimit objekt padie (*shih faqe 11 – 12 të*



*vendimit*). Në këtë mënyrë del qartë se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka ofruar akses të mjaftueshëm si në kohë, informacion dhe mundësi mbrojtje për palën paditëse gjatë periudhës së verifikimit të kandidimit të saj, në përputhje me kërkesat apo standardet e nenit 44, 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative.

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pretendimi i palës paditëse për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit apo mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit në ushtrimin e pushtetit diskrecial të organit të administratës publike është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të rrëzohet. Sjellim në vëmendje se vendimi prej 13 faqesh i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi respekton detyrimin e formës së një akti administrativ të organit kolegjal, sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi akti është i shkruar, përmban pjesën hyrëse, përmban emrin e organit publik që nxjerr aktin; palët të cilave u drejtohet akti; datën e miratimit; bazën ligjore; pjesën arsyetuese; dispozitivin që tregon dhe pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur; kohën e hyrjes në fuqi të aktit; të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit. Nga ana tjetër Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sjell në vëmendje se akti administrativ objekt padie respekton edhe nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative për sa i përket përmbajtjes së tij në standardin e arsytimit të vendimit. Në arsyetimin e vendimit objekt padie gjendet shpjegimi i situatës faktike mbi të cilën ai është marrë, analizimi i detajuar i procedurës së verifikimit, paraqitjen e përmbledhur të rezultateve të çdo verifikimi, paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të kandidatës mbi verifikimet dhe rezultatet e administruara, shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast; në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar. Në secilën pjesë respektive të aktit administrativ objekt padia mund të shquhen qartë nga çdo lexues i ftohtë secila nga pjesët e listuara më lart në mënyrë abstrakte. Për rrjedhojë përmbajtja e arsytimit të aktit është realizuar sipas kërkesave ligjore.

- Lidhur me themelin e vlerësimit të bazuar në konkluzioneve të ILDKPKI vlerësojmë se i tillë ishte vlerësimi dhe konkluzioni i 8 anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke evokuar bazueshmërinë në prova dhe në ligj të secilës gjetje të ILDKPKI dhe se për rrjedhojë nuk mund të ketë vend që të vihet në diskutim përmbajtja dhe mënyra e ushtrimit të vlerësimit diskrecionar të vendimmarrjes së secilit anëtar dhe në tërësi të organit kolegjal.

### **Vlerësimi i kolegjit administrativ**

**Kolegji Administrativ pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoji palët, analizoi rrethanat, faktet dhe ligjin çmon se padia duhet të rrëzohet me arsyetimin si më poshtë vijon:**

*Së pari:* gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7/a, nenit 10/2/b të Ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 238 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.



Neni 7/a dhe 10/2/b i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikojnë:

Neni 7

*Kompetenca lëndore*

*Gjykatat administrative janë kompetente për:*

*a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;*

Neni 10

*2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:*

*a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;*

*b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.*

Neni 238 i Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, parashikon:

*“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkellje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.*

Objekt gjykimi është vendimi nr. 11, datë 17.07.2020, i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatës Ardita Buna, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për të cilat në bazë të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 kompetente për gjykimin e tyre është Gjykata Administrative e Apelit.

*Së dyti:* Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimit objekt shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi është brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 238 i ligjit 115/2016 sipas të cilit: “Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkellje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar”.

Në rastin konkret, Vendimi nr. 11, datë 17.07.2020 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezulton t'i jenë komunikuar paditëses, Ardita Buna, në rrugë postare, në datë 30.07.2020, ndërsa padia rezulton të jetë dorëzuar dorazi në datë 03.08.2020, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit, pra brenda afatit ligjor 5-ditor.

*Së treti:* Lidhur me pretendimet e ngritura në padinë e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, paditësja ka ngritur si pretendime për pavlefshmërinë relative ashtu edhe pretendime për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Në këtë kontekst gjykata çmon të ndalet në radhë të parë në natyrën e këtij gjykimi dhe hapësirën që ligji i ka lënë gjykatës në këto lloj gjykimesh.

Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

*“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. **Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.**”*

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

*“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.***

*2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:*

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”*

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, është parashikuar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuadër paditësja ka paraqitur kandidaturën për të qenë pjesë e saj nga radhët jo magjistrat. Ky ligj dhe aktet nënligjore kanë parashikuar procedurën që duhet të ndiqet për tu bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kushtet që



duhet të plotësojë kandidati, organin që vendos për ndalimin, si dhe gjykatën ku mund të paraqitet ankimi.

Neni 234 parashikon:

*1. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.*

*2. Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.*

Neni 235 parashikon:

*1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë.*

*2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.*

*3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.*

***4. Me përfundimin e procedurës së deklarin dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar***

Neni 238 parashikon:

*Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit*

***1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.***

***2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.***

*3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.*

Në bazë të pikës 2 të nenit 229, i padituri KED ka nxjerrë vendimin nr. 4, dt.11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, mbi të cilin është bazuar në veprimtarinë e tij administrative në shqyrtimin e aplikimit të paditëses Ardita Buna, për pasojë edhe ky vendim është pjesë e akteve nënligjore mbi të cilat ky kolegji bazohet në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi.

Paditesja Ardita Buna është një ndër personat që ka shprehur interes për të kandiduar, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, procedura e kandidimit të të cilës rezulton të jetë ndërprerë me aktet objekt gjykimi, për shkak të kriterit të pasurisë.

Pra duke iu referuar këtyre dispozitave Gjykata konstaton veçantitë e këtyre lloj gjykimesh dhe konkretisht:

*Së pari:* Në gjykatë paditesja mund të ngrejë padi vetëm për çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, bile jo për çdo shkak që sjellë pavlefshmërinë absolute, por vetëm me shkakun e parashikuar nga neni 108/1/a pika “ii” të K.Pr.Administrative, pra vetëm për shkelje të rënda të procedurës së organit vendimarrës dhe për asnjë shkak tjetër të pavlefshmërisë absolute.

*Së dyti:* Ligji nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ka kufizuar hapësirën e gjykimit gjykatës, vetëm për një nga rastet e pavlefshmërisë absolute duke i hequr asaj mundësinë të marrë në shqyrtim çështje të tjera që paditëses mund të ketë pretendim, për pavlefshmërinë absolute. Po kështu ky ligj i ka hequr mundësinë gjykatës të marrë në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të aktit.

Nga aktet e administruara në gjykim, shpjegimet e palëve në proces rezultoi e provuar se në përfundim të procesit të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidates Ardita Buna, relacioni i përgatitur nga anëtarja relatorja e çështjes, mbi “Gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidaturës së zonjës Ardita Buna për vendin vakant për Gjykatë Kushtetuese, shpalluar nga Kuvendi i Shqipërisë”, është kaluar për shqyrtim pranë organit kolegjal KED.

Në përfundim të mbledhjes së datës 17.07.2020, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi rezulton se ka marrë vendimin nr.11, datë 17.07.2020, me të cilin ka vendosur: “Ndalimin e kandidimit të kandidates Ardita Buna (Alsula), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019”.

Akti administrativ që ka ndaluar kandidimin e paditëses Ardita Buna, ka si shkak, atë të mos plotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr.8577/2000 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, që i përket kriterit të pasurisë.



ILDKPKI, me shkresën nr.prot.4186/6, datë 06.11.2019 i ka dërguar KED, aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave, lidhur me periudhën e verifikuar ku ka ardhur në përfundimin, se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë,
- e) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Pretendimet e ILDKPKI, bazohen në gjetjet e raportit të kontrollit:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e deklaruara nga bursat e Universitetit të Trentos, College of Laë London, Trinity College Dublin, IDAIC, UNIDROIT në vlerën totale 23.300.000 Lireta dhe 7.300 Paund;*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues financiar lidhur me të ardhurat e deklaruara pranë Univeritetit të Shkodrës, Ministrisë së Drejtësisë, Fakultetit të Drejtësisë, shoqërisë Alb Juris sh.p.k., Kolegjit Qirjazi;*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 55 m2 në rrugën e Barrikadave Tiranë në vitin 2002, deklaruar në vlerën 2.000.000 Lekë;*
- *Mospërputhje e vlerës së deklaruar për apartamentin me sipërfaqe 55 m2 rruga e Barrikadave Tiranë, të blerë në vitin 2002, pasi është deklaruar 2.000.000 Lekë ndërsa kontrata e shitblerjes rezulton të jetë në vlerën 200.000 Lekë;*
- *Mospërputhje për sipërfaqen e pasurisë garazh, rruga "Kongresi i Manastirit", Tiranë, pasi në kontratën e porosisë datë 27.06.2014 është përcaktuar sipërfaqe 200 m2, ndërsa nga kandidati deklarohet 240 m2;*
- *Konstatohet se për blerjen e garazhit me sipërfaqe 240 m2, Tiranë, ndër të tjera është deklaruar si burim kredia në vlerën 4.000.000 Lekë pranë Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., por rezulton që kjo kredi është disbursuar pas lidhjes së kontratës së porosisë, gjithashtu përcaktohet se është marrë për rikonstruksion banese."*

Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mbi gjetjet e sipërcituara, është njoftuar paditësja, kandidatja Ardita Buna në datë 08.11.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon. Paditësja, në datë 14.11.2019, ka depozituar shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues. (për më tepër shih pikën 55 të vendimit objekt ankimi).

Sikundër u arsyetua më lartë mbi gjetjet e kryera në raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, në këtë vendim pala paditëse i kundërshton aktet e palës së paditur duke pretenduar se janë të pabazuara konkluzionet e nxjerra prej saj në lidhje me vlerësimin e kryer mbi kriterin e pasurisë, konkretisht:

- *Përsa i përket konkluzionit se dokumentacioni justifikues në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga bursat, punësimi etj është jo i plotë, bashkëlidhur po dërgoj një dokument*



shtesë që kam siguruar gjatë këtyre ditëve, konkretisht një artikull historik nga IDAIC (Instituti për Unifikimin e të Drejtës Agrare të Krahasuar) ku përmendet emri im si bursiste dhe një vërtetim të lëshuar nga Universiteti i Shkodrës për të ardhurat nga punësimi për periudhën 1993 -1996. Këto të ardhura nuk kanë shërbyer si burim për të krijuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme; Të gjitha këto janë deklaruar duke menduar se është e pershtatshme që të deklarohen të gjitha të ardhurat nga studimet dhe punësimi.

- Është i pabazuar konkluzioni se ka deklarim të pasaktë të çmimit të shitjes së apartamentit me sip. 55 m<sup>2</sup>, të ndodhur në "Rrugën e Barrikadave" dhe se çmimi prej 200.000 Lekë gjykohet të jetë i ulët referuar zonës dhe vitit të blerjes. Me shitësit, z. Fadil Paçrami dhe z. Fatos Paçrami kemi lidhje të ngushtë familjare dhe kjo është arsyeja e shitjes së apartamentit jo me çmimin e tregut, por në kontratë është vendosur çmimi real i shitjes (shiko deklaratën noteriale nr. 2323 Rep., nr. 776/3 kol., datë 23.10.2019). Nuk jam në situatën e konfliktit të interesit apo të përfitimit për shkak të detyrës publike. Për më tepër, kjo pasuri është fituar nga bashkëshorti im para lidhjes së martesës dhe nuk kam patur asnjë mundësi të përcaktoj kontratën e shitjes;
- Përsa i përket konkluzionit se ka pasaktësi në deklarimin e sipërfaqes së pasurisë garazh, rruga "Kongresi i Manastirit", ku sipërfaqja është 200 m<sup>2</sup> dhe është deklaruar 240 m<sup>2</sup>, unë i jam referuar çertifikatës së pronësisë së karabinasë dhe diferenca prej 40 m<sup>2</sup> është pjesa e përbashkët e gjithë pallatit. Kjo diferencë nuk ka ndikuar gjithsesi në çmimin e blerjes;
- Është i pabazuar konkluzioni se kontrata e kredisë që ka shërbyer si burim i pjesshëm i krijimit të pasurisë garazh, në fakt është lidhur pas datës së kontratës së porosisë. Kontrata e kredisë është lidhur një muaj para se të lidhej kontrata e porosisë për garazhin dhe ndërkohë pritej disbursimi. Në momentin e lidhjes së kontratës porositësit i është paguar tërësisht vlera tjetër me përjashtim të vlerës që mbulonte kredia. Ky fakt ishte i njohur nga shitësi, i cili për shkak të besimit që kishte tek blerësi (për shkak të njohjeve që në fëmijëri me bashkëshortin tim), ra dakord që në kontratë të shënohej sikur vlera ishte likuajduar tërësisht.
- Bashkëlidhur parashtrimeve gjendet shkresa me lëndë "Vërtetim" me nr. 2883/1 prot., datë 09.09.2019 e lëshuar nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Kolegji, vlerëson se pretendimet e paditëses janë të pambështetura në ligj për shkak se nuk u provua në këtë gjykim se pala e paditur në ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative, e cila në bazë të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 e ushtron atë në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave të përcaktuara në pjesën e pestë të ligjit nr. 115/2016 të cilat plotësohen për aq sa është e mundur me ligjin nr. 8480 datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

**Neni 229 i ligjit nr. 115/2016, rregullon veprimtarinë e vendimmarrjes së organit kolegjial KED, konkretisht:**

Mënyra e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimmarrjes



1. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë kre, të cilat, plotësohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.

3. Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve.

4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në procesin e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe të vlerësimit të kriterëve profesionale e morale kërkon informacione nga institucione të tjera.

5. Në përfundim të procesit të verifikimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, bën renditjen e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240, të këtij ligji, dhe harton një raport ku arsyeton këtë renditje.

**Neni 238 i ligjit 115/2016 që e bën kompetente këtë gjykatë nga pikëpamja e lëndës ndër të tjera ka parashikuar se: 1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit”.**

Nga analiza e kësaj dispozite arrihet në konkluzionin se duhet të provohet që nga i padituri KED janë kryer shkelje të rënda procedurale, gjatë veprimtarisë administrative të tilla që e çenojnë procesin dhe për pasojë sjellin pavlefshmërinë e tij.

Ka rezultuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje se nga ana e palës së paditur janë zhvilluar të gjitha procedurat në bazë të ligjit nr. 115/2015 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit në Drejtësi”, dhe vendimi nr.4, dt.11.03.2019 të KED dalë në zbatim të këtij ligji i cili parashikon të gjithë procedurën që do ndiqet për të gjithë kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese.

Nepermjet akteve shkresore të administruara gjatë gjykimit, rezulton të jete konfirmuar se:

- Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi i Republikës, në datën 28.08.2018 ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të ish- gjyqtarit . Po ky vend është rishpallur për hapjen e procedurës, në datën 21.08.2019.
- Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Republikës, i kanë dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.



- Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Ardita Buna (Alsula).
- Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të pikës 1 të Kushtetutës, të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 228, 229 e nenit 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 21.09.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vakancën e parakohshme të krijuara në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.
- Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 21.09.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
- Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018 dhe të rishpallur në datën 21.08.2019, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari Fatri Islamaj. Në kushtet kur anëtari i KED i është nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, me vendimin e datës 11.12.2019 KPK ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të vlerësimit. Në kushtet kur ligji parashikon pezullimin e menjëhershëm të gjyqtarit, nga detyra, KED ka zhvilluar sërish shortin manual në datën 11.12.2019, me të cilin është caktuar si relatore e çështjes znj. Vitore Tusha, për shkak të përfundimit të mandatit të KED në vitin 2019, në rishortimin manual të çështjes, rezulton të jetë caktuar si relatore, anëtarja e Këshillit zonja Saida Dollani.
- Znj. Ardita Buna (Alsula), si një ndër kandidatet që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në



rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Ardita buna (Alsula), gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

- Në datën 23.09.2019, kandidatja Ardita Buna (Alsula) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatës të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
- Në datën 24.09.2019, kandidatja Ardita Buna (Alsula) ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
- Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 548 prot, datë 04.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.
- Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Ardita Buna (Alsula), ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
- Me shkresën nr. 107/27 prot, datë 06.11.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Ardita Buna (Alsula) e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë. Deklarata është dorëzuar në datën 05.09.2019.
- ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.4186/6 prot., datë 06.11.2019, ka dërguar pranë Këshillit të

Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Ardita Buna (Alsula) dhe personat e lidhur me të.

- Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Ardita Buna (Alsula) dhe personave të lidhur me të.
- Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidates Ardita Buna (Alsula), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.10.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:
- Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.
- Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 16 më sipër, kanë dërguar



pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Ardita Buna (Alsula).

- Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, i padituri Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka njoftuar kandidaten Ardita Buna në datën 08.11.2019, në rrugë elektronike, për të marrë të dhënat mbi raportin e hartuar nga ILDKPKI si dhe të mundësojë dhënien e shpjegimeve përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.
- Paditësja, kandidatja Ardita Buna, në datë 14.11.2019, në rrugë zyrtare, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, i cili është protokolluar pranë sekretarisë së KED-së.
- Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr.115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", anëtari i Këshillit, relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

Në lidhje me pretendimet e palës paditëse mbi mungesën e arsytimit, Kolegji vlerëson se referuar vendimit objekt gjykimi rezulton që nga pikat 50 deri në pikën 58 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e keshillit për ndalimin e kandidimit të palës paditëse, si dhe i është dhënë përgjigje edhe pretendimeve që paditësja ka paraqitur në formën e objeksioneve dhe sqarimeve që një herësh një pjesë e tyre janë ngritur në këtë padi nga pala paditëse, duke arsyetuar qartë faktet, rrethanat dhe provat.

Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse se i padituri ka keqinterpretuar apo ka interpretuar gabim ligjin pasi ky pretendim ngrihet në nivel të pavlefshmërisë relative të akteve dhe nuk është objekt shqyrtimi nga ky kolegji pasi sikundër u arsyetua më lart nga ky kolegji në këtë vendim, mund të merren në shqyrtim vetëm shkeljet e rënda të procedurës të kryera për të paditurit KED.

Në kushtet kur paditësja kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 11, datë 17.07.2020 "*Ndalimin e kandidimit të kandidatës, Ardita Buna, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakantë e përkohshme e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë*", në kuptim të dispozitës nenit 238/1 të ligjit nr.115/2016, shkeljet e procedurës duhet të jenë aq të rënda sa e bëjnë procesin nul. Referuar në nenin 108 të K.Pr.Administrative, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara asnjë shkelje që të çojë në nulitetin e aktit administrative objekt shqyrtimi gjyqësor.

Sa i përket pretendimit të paditëses lidhur me përmbajtjen e relacionit të hartuar për dosjen dhe të vendosur në dispozicion paditëses dhe arsytimit dhe përmbajtjes së vendimit, sikurse shprehet: *“Pra ndryshe nga sa është arsyetuar relacioni që është dërguar përmban vetëm të dhëna të tjera. Siç vihet re nga vetë përmbajtja e vendimit tek pjesa arsyetuese, rezulton se relatorët e çështjes janë paragjykuar si dhe kanë paracaktuar mos lejimin e kandidimit”*, Kjolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë duhet rëzuar.

Relatori i çështjes ka detyrë ligjore të realizojë studimin e rrethanave, ligjit, praktikës gjyqësore, jurisprudencës dhe më tej edhe të formësimit të konkluzioneve të rrjedhura logjikshëm nga analiza, të cilat i pasqyron në relacion. Hartimi i relacionit nga relatori, pavarësisht gjetjeve dhe propozimeve apo jo të mundshme, nuk mund të diktojë një qëndrim të caktuar në anëtarët e Këshillit. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe ai vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve.

Sa i përket pretendimit të ngritur nga paditësja, në lidhje me thirrjen e një eksperti, veprim ky i cili nuk është kryer nga KED, duke bërë që pala e paditur të mbajë qëndrime të ndryshme për kandidatë të ndryshëm, Kolegji konstaton se, në pikën 74, gërma A, Kreu IV “Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve” parashikohet: *Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti”*. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, Kolegji vlerëson se, vetë ligjëvënësi e ka vlerësuar “caktimin e ekspertit” opsionale dhe jo detyruese, si një zgjidhje të mundshme procedurale, në kushtet kur vetë organi Kolegjial KED, e shikon të rëndësishme për vlerësimin sa më të drejtë të situatës financiare të kandidatëve. Pala paditëse nuk provoi dhe argumentoi se mos caktimi i një eksperti ka qenë kërkesë e saj procedurale, se pse mos caktimi i një eksperti e cenon procesin administrativ deri në atë pikë sa të bëjë të palvefshëm të gjithë procedurën e ndjekur nga KED në vendimmarrjen konkrete objekt gjykimi.

Kolegji vlerëson se në kuadër dhe të arsytimit të lartpërmendur pretendimet e parashtruara nga pala paditëse, në padinë objekt gjykimi mbi shfuqizimin e vendimit nr. 11, datë 17.07.2020 janë të pambështetur në ligj, pasi sikundër u citua sa sipër, kjo Gjykatë shqyrton vetëm shkeljet e rënda të procedurës të konstatuara gjatë miratimit të vendimeve të organit kolegjial KED, të cilat nuk rezultuan se janë kryer prej tij.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 238 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”



**VENDOSI**

- Rrëzimin e kërkesë padisë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.

U shpall më 10.08.2020 në Tiranë.

**GJYQATAR  
BARI SHYTI**



**GJYQTARE  
ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)**



**GJYQTARE  
ALKELINA GAZIDEDJA**

